




Pastruesi i ajrit

Lloji i qëndrimit në dysHEME ose mbi tavolinë

Modeli
MC30YVM

Pastruesi i ajrit MANUALI I PËRDORIMIT



- Faleminderit për blerjen e pastruesit të ajrit.
- Lexoni me kujdes manualin e përdorimit dhe ndiqeni për një përdorim të saktë.
- **Lexoni pjesën "Masat paraprake të sigurisë" para përdorimit.** ► Faqe 2,3
Ruajeni manualin e përdoruesit në një vend të sigurt për referencë të mëvonshme.

Vetëm për përdorim
të brendshëm
3P664947-9 D



Përmbajtja

Së pari lexoni



Masat paraprake të sigurisë	2
Emrat e pjesëve dhe operimet.....	4
Përgatitja para operimit	6

Operimi

Përdorimi i operimit të pastrimit të ajrit	9
Ndryshimi i shkallës së qarkullimit të ajrit	9

Funksione të dobishme

Operimi i njësisë në një MODALITET	10
MODALITETI GJUMË	
Përdorimi i bllokimit me kyç për fëmijë	11
Përshtatja e ndriçimit të llambës së treguesit	11

Cilësimet e përparuara

Cilësimet e daljes të Streamer	12
--------------------------------------	----

Mirëmbajtja

Mirëmbajtja	13
Pjesët e shitur veçmas / Kur nuk e përdorni njësinë për periudha të gjata	15

Zgjidhja e problemeve

Rreth llambave të treguesit	16
Pyetjet e shpeshta	17
Zgjidhja e problemeve	18
Specifikimet	21

Teksti në anglisht është udhëzimi original.
Gjuhët e tjera janë përkthime të udhëzimeve origjinale.

Masat paraprake të sigurisë

■ Zbatoni këto masa paraprake për të parandaluar dëmtimin e pronës ose lëndimin.

■ Pasojat e përdorimit të pasaktë janë të kategorizuara si më poshtë:

 PARALAJMËRIM	 KUJDES
Mosndjekja e këtyre udhëzimeve si duhet mund të çojë në lëndim fizik ose humbje të jetës.	Mosndjekja e këtyre udhëzimeve si duhet mund të çojë në dëmtimin e pronës ose lëndim fizik, gjë e cila mund të jetë e rëndë në varësi të pasojave.

■ Masat paraprake që duhen zbatuar janë të kategorizuara duke përdorur simbolet:

 Mos e provoni asnjëherë.	 Sigurohuni të ndiqni udhëzimet.
--	---

 **PARALAJMËRIM** Kontrolloni për të parandaluar zjarrin, goditjet elektrike ose lëndimin e rëndë fizik.

■ Në lidhje me spinën dhe kordonin e furnizimit me energji elektrike

-  • Mos e hiqni njësinë nga priza kur është në operim. (Nga nxejha mund të shkaktohet zjarr ose goditje elektrike)
- Mos e fusni në prizë dhe mos e hiqni atë nga priza me duar të lagura. (Mund të shkaktohet goditje elektrike)
- Mos e përdorni në një mënyrë që të mos kalohen shkallët e prizës së korrentit ose të pajisjeve të instalimeve elektrike se përdorni një voltazh të gamës AC220-240V. (Mund të shkaktohet zjarr nga nxejha, nëse kalohen shkallët e përshtatësve të energjisë për sistemin me shumë priza etj.)
- Mos e tërhiqni kordonin e korrentit kur e hiqni atë nga priza. (Mund të shkaktohet nxejhe ose zjarr nga prishja e telave)
- Mos kryeni veprime që mund t'i dëmtojnë ato.
 - Veprime të tilla përfshijnë dëmtimin, modifikimin, lakimin me forcë, tërheqjen, përdredhjen, lidhjen në grup, vendosjen e sendeve të rënda në spinën ose kordonin e korrentit. Nëse dëmtohet spina ose kordoni i korrentit, duhet të ndërrohet nga prodhuesi, agjenti i shërbimit ose persona të ngjashëm të kualifikuar për të shmangur një rrezik. (Mund të shkaktohet goditje elektrike, qark i shkurter ose zjarr nga përdorimi kur është i dëmtuar)

-  • Futeni mirë spinën e energjisë elektrike deri në fund.
 - Mos përdorni spinë të dëmtuar ose një prizë të liru.
 - (Mund të shkaktohet goditje elektrike ose zjarr për shkak të nxejhes ose qarkut të shkurter, nëse spina nuk është vendosur mirë)
- Hiqni herë pas here pluhurin nga spina me një leckë të thatë.
 - Nëse njësia nuk do të përdoret për një periudhë të gjatë, hiqeni nga priza. (Mund të shkaktohet zjarr ose mbinxhe nga izolimi i paplotë që vjen si pasojë e lagështirës etj.)
- Kur kryeni mirëmbajtjen, inspektimin ose lëvizjen e njësive, sigurohuni ta fikni dhe ta hiqni njësinë nga priza. (Mund të shkaktohet goditje elektrike ose lëndim)

■ Mos e përdorni në këto vende

-  • Vende ku përdoren vaji ose gazrat e djegshme ose ka rrjedhje të tyre. (Mund të shkaktohet zjarr ose tym nga ndezja ose thithja drejt njësive, ose mund të shkaktohet lëndim nga degradimi ose plasaritja e plastikës)
- Vende ku ka gaz gjërryes ose grimca metalike në pluhur. (Mund të shkaktohet zjarr ose tym nga ndezja ose thithja drejt njësive)
- Vende ku temperatura dhe nivelet e lagështisë janë të larta ose ku mund të shpërndahet ujë, si banja. (Mund të shkaktohet zjarr ose goditje elektrike nga nxejha elektrike)
- Vende ku arrihen nga fëmijët e vegjël. (Mund të shkaktohet goditje elektrike ose lëndim)

■ Gjatë përdorimit

-  • Mos përdorni detergjente me klor ose acid. (Lëndimi mund të shkaktohet nga degradimi ose plasaritja e plastikës, ose dëmtimi ndaj shëndetit mund të shkaktohet nga prodhimi i gazrave toksike)
- Mbani cigaret e djegura ose shkopinj të temjanit larg njësive. (Mund të shkaktohet zjarr ose tym nga ndezja ose thithja drejt njësive)
- Mos tentoni ta çmontoni, rikonstruktioni ose riparoni njësinë vetë. (Mund të shkaktohet zjarr, goditje elektrike ose lëndim) Për riparime, kontaktoni me pikën e blerjes.
- Mos futni gishtat, shkopinj ose sende të tjera në pjesët hyrëse apo dalje të ajrit. (Mund të shkaktohet goditje elektrike, lëndim fizik ose dëmtim)
- Mos hidhni ujë mbi pjesën dalëse të ajrit ose njësive. (Mund të shkaktohet zjarr ose goditje elektrike)
- Mos përdorni substanca të djegshme (spërkatës flokësh, insekticide etj.) afër njësive.
- Mos e pastroini njësive me benzinë ose hollues. (Mund të shkaktohet goditje elektrike, zjarr ose plasaritja)

■ Nëse ka shenja anomalie ose dëmtimi, fikni menjëherë njësive dhe hiqeni nga priza

-  • Shembuj të anomali ose dëmtimit
 - Njësia nuk operon edhe kur çelësi është i ndezur.
 - Rryma kalon nga kordoni vetëm ndonjëherë nëse kordoni hiqet.
 - Gjatë operimit ka zhurma ose dridhje anormale.
 - Kasa e njësive është deformuar ose është e nxehtë, diçka që nuk ndodh normalisht.
 - Ka një aromë djegieje. (Mund të shkaktohet keqfunksionim, goditje elektrike, tym, zjarr etj., nëse nuk zgjidhet kjo anomali dhe njësia vazhdon të përdoret)
- Kontaktoni me vendin e blerjes.

Masat paraprake të sigurisë



KUJDES Kontrolloni për të parandaluar krijimin e qarqeve të shkurtra, lëndimin fizik ose dëmtimin e pronës.

■ Gjatë përdorimit



Fëmijët e vegjël ose personat që nuk mund të lëvizin (për shkak të sëmundjes ose dëmtimit) nuk duhet ta përdorin vetë njësinë.

◆ Për BE-në:

Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e sipër dhe persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijmësh ose mendore ose që nuk kanë eksperiencë dhe njohuri, nëse janë nën mbikëqyrje ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe i kuptojnë rreziqet e përdorimit.

Fëmijët nuk do të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja e përdoruesit nuk do të kryhet nga fëmijë pa mbikëqyrje.

◆ Për vende të tjera përveç BE-së:

Kjo pajisje mund të përdoret nga persona (duke përfshirë fëmijët) me aftësi të kufizuara fizike, ndijore ose mendore ose që nuk kanë eksperiencë dhe njohuri, përveç nëse u kanë ofruar mbikëqyrje ose udhëzime mbi përdorimin e pajisjes nga një person përgjegjës për sigurinë e tyre.

– Fëmijët duhet të kontrollohen për të siguruar se nuk luajnë me pajisjen.

– Personat që janë të dehur rëndë ose kanë marrë ilaçe për gjumë nuk duhet ta përdorin njësinë. (Mund të shkaktohet goditje elektrike, lëndim fizik ose dobësim i shëndetit)

• **Mos përdorni afër njësisë produkte që përmbajnë pluhur të imët, si artikuj kozmetikë.**

(Mund të shkaktohet goditje elektrike ose keqfunksionim)

• **Mos e përdorni njësinë kur po përdoret dezinfektimi me insekticide.**

– Pas përdorimit të insekticideve, sigurohuni të ajrosni mjaftueshëm dhomën para se të operoni njësinë.

(Mund të shkaktohet dëmtim i shëndetit nga rrjedhja e përbërësve të mbledhur kimikë në pjesën dalëse)

• **Mos e përdorni afër një detektor tiumi.**

– Nëse ajri që del nga njësia shkon në drejtim të detektorit të tiumit, reagimi i detektorit të tiumit mund të vonohet ose mund të mos arrijë të zbulojë tium.



• **Ajrosni herë pas here dhomën kur përdorni njësinë së bashku me pajisjet e ngrohjes me djegie.**

– Përdorimi i këtij produkti nuk e zëvendëson ajrimin. (Shkak i mundshëm për helmim me monoksid karboni)
Ky produkt nuk mund ta eliminojë monoksidin e karbonit.

• **Nëse njësia vendoset në një vend që mund të arrihet nga një kafshë shtëpiake, bëni kujdes që ajo të mos urinojë mbi njësinë ose të përtypë kordonin.** (Mund të shkaktohet zjarr, goditje elektrike ose lëndim)

■ Në lidhje me trupin e njësisë



• **Mos i pengoni pjesët hyrëse ose dalëse të ajrit me rroba, lecka, perde etj.**

(Mund të shkaktohet mbinxehje ose zjarr nga qarkullimi i dobët)

• **Mos u ngjitni, ulni ose mbështetuni në njësi.** (Mund të shkaktohet lëndim fizik nga rrëzimi ose përmbysja)

■ Kur zhvendosni njësinë



• **Kur merrni njësinë për ta lëvizur, kapeni me kujdes.**

– Sigurohuni ta mbani njësinë gjithmonë duke përdorur dorezat e duhura.

Mos e mbani njësinë duke përdorur dorezën e filtrit të heqjes së aromës.

(Mund të shkaktohet lëndim fizik nga rrëzimi)

Mos e kapni këtë dorezë



Mos i kapni këto doreza (2 vende)



CJ0R002EU

Masat paraprake gjatë përdorimit

Gjëra të tjera për t'u marrë parasysh

■ **Mos e përdorni produktin për qëllime të veçanta si në ruajtjen e punëve të artit, teksteve/ materialeve akademike etj.**


(Mund të shkaktohet degradimi i artikujve të ruajtur)

Emrat e pjesëve dhe operimet


⚠ KUJDES

Mos e ngrijeni njësinë duke e mbajtur nga doreza në njësinë e filtrit të heqjes së aromës. (Mund të shkaktojë rrëzimin përmbysi)

Para



Prapa




Pjesët kryesore të lëvizshme


Kujdes

Për të parandaluar keqfunksionimin, sigurohuni ta përdorni njësinë me të gjitha pjesët e fiksuar.

Ana




Para



Emrat e pjesëve dhe operimet

Paneli i operimit/treguesit

Kur llamba vezullon ►Faqe 16



① Rreth llambës së bllokimit me kyç për fëmijë


- Kur bllokimi me kyç për fëmijë është aktiv, operimet do të kufizohen. Kur shtypet çfarëdo butoni, do të bjerë një tingull (3 bipe të shkurtra), duke e parandaluar operimin e gabuar nga fëmijët e vegjël. ►Faqe 11

② Rreth llambës Streamer


- Llamba ndriçon kur Streameri është në përdorim. Operimi i Streamer kontrollohet me kohë.
- Nëse ju shqetëson zhurma e fërshtëllimës e krijuar nga shkarkimi i Streamer ose era e ozonit, vendoseni daljen e Streamer në "I ulët". ►Faqe 12

Paneli i operimit/treguesit**Butoni NDEZUR-FIKUR**

Shtypni për të ndezur energjinë (ON) ose për ta fikur (OFF)

**Aksesorë**

Manuali i përdorimit ... 1




Filtri i heqjes së aromës....1
Fiksoni në njësi para operimit.

Përgatitja para operimit

1 Pozicionimi i njësiesë

Para instalimit, hiqni ngjytësen e fiksimit të kordonit të energjisë elektrike me fundin e njësies dhe nxirrni kordonin e energjisë elektrike.

**Këshilla për një pozicionim të mirë**

- Zgjidhni një pozicion nga ku qarkullimi i ajrit mund të arrijë të gjitha sipërfaqet e dhomës.
- Vendoseni në një sipërfaqe të qëndrueshme. Nëse njësia është e vendosur në një sipërfaqe të paqëndrueshme, mund të shtohen dridhjet nga njësia.
- Nëse gjeni që interferenca nga qarku i energjisë brenda njësies ose kablove shkakton ndërhyrje në ekranin e televizorit ose emetim të zhurmës statike nga radiot ose riprodhimet stereofonike afër, lëvizni njësien të paktën 2 m larg pajisjes. Edhe telefonat pa kordon dhe orët e kontrolluara me radio mbajini larg njësiesë.

Kujdes

- Për të shmangur njolllosjen e mureve, poziciononi njësien në përputhje me masat e pozicionimit në ilustrim. Megjithatë, mbani parasysh se meqenëse kjo njësi tërheq ajër të papastër, lloje të caktuara muresh mund të bëhen me njolla edhe nëse zbatohen masat. Në raste të tilla, sigurohuni të ruani distancë të mjaftueshme mes njësies dhe murit.
- Kur përdoret për një periudhë të gjatë kohe në të njëjtën vend, dyshemeja dhe muret rrethuese mund të bëhen me njolla sepse ajri tërhiqet në pjesët hyrëse të ajrit afër bazës së njësies. Rekomandohet pastrimi i njësies në mënyrë periodike.

Përgatitja para operimit

Mos e përdorni në këto vende


- **Mos e ekspozoni ndaj diellit të drejtpërdrejtë të ajrit.**
(Mund të shkaktohet çngjyrosje)
- **Mos e poziciononi afër pajisjeve të ngrohjes me bazë djegieje dhe afër pajisjeve të tjera me temperaturë të lartë.**
(Mund të shkaktohet çngjyrosje ose deformim)
- **Mos e ekspozoni në vende ku përdoren lëndët kimike ose farmaceutike si spitale, fabrika, laboratorë, sallonet e bukurisë dhe laboratorët fotografikë.**
(Lëndët kimike që avullojnë dhe tretësit mund të degradojnë pjesët mekanike dhe çojnë në keqfunksionim)
- **Mos e ekspozoni në nivele të larta të valëve elektromagnetike si për shembull afër një furnele elektromagnetike, altoparlantëve etj.**
Njësia mund të mos funksionojë si duhet.
- **Mos e ekspozoni ndaj blazës (pluhur përçues) e lëshuar nga qirinjtë, qirinjtë aromatikë etj.**
Performanca e filtrave mund të dëmtohet, duke shkaktuar kështu ndotjen e dhomës si rrjedhojë e grumbullimit të pluhurit që nuk është kapur.

- **Mos përdorni afër njësisë artikuj kozmetikë dhe gjëra që ngjashme që përmbajnë silikon*.**

- * Produktet për kujdesin e flokëve (agjentë për veshjen e fijeve fundore që ndahen, agjentët për trajtimin e flokëve etj.), artikujt kozmetikë, substancat kundër djersitjes, agjentët anti-statikë, spërkatësit kundër ujit, agjentët e shkëlqimit, pastruesit e qelqit, leckat për fshirjen e lëndëve kimike, dylli etj.
- Nëse një izolator si silikonin ngjitet në gjilpërën e njësisë Streamer, mund të mos gjenerohet shkarkimi në këtë njësi.
 - Filtri i mbledhjes së pluhurit mund të bllokohet duke çuar kështu në kapacitet të reduktuar të pastrimit të ajrit.

- **Mos përdorni lagështues ultrasonik ose pajisje të ngjashme afër njësisë.**

- Filtri i mbledhjes së pluhurit mund të bllokohet duke çuar kështu në kapacitet të reduktuar të pastrimit të ajrit.




Rreth shkarkimit të Streamer

Në disa raste pjesa dalëse e ajrit mund të lëshojë një aromë të lehtë teksa gjenerohen sasi gjurmësh të ozonit. Megjithatë, sasia është e papërfillshme dhe jo e dëmshme për shëndetin tuaj.

Ky produkt nuk mund të eliminojë substancat toksike në tymin e duhanit (monoksidi i karbonit etj.)

2 Futni spinën e energjisë elektrike në prizë

- Futni spinën e energjisë elektrike në ON në njësi.



3 Vënia e filtrit të heqjes së aromës




KUJDES

Kryeni këto hapa para se të futni spinën e energjisë elektrike.


1. Hiqni njësinë e filtrit të heqjes së aromës nga njësia kryesore. ►Faqe 14

Njësia e filtrit të heqjes së aromës



Ana prapa e njësise së filtrit të heqjes së aromës


Grrëmçat



Pjesët e fiksuar


2. Hiqni nga qesja filtrin e heqjes së aromës.

Meqenëse mund t'i bëni duart pis nga pluhuri i filtrit të heqjes së aromës, sigurohuni të mbani doreza dhe të lani duart pas procesit.



3. Vini filtrin e heqjes së aromës.


- ① Vendosni filtrin e heqjes së aromës nën pjesët e fiksuar. (2 vende)



- ② Kur shpërndani xhungat në grrëmçat e filtrit të heqjes së aromës, shtyni brenda filtrin dhe vendoseni nën grrëmça në 2 vende për ta fiksuar.



- ③ Kontrolloni dy herë për të parë nëse filtrin e heqjes së aromës është nën grrëmça.




4. Instaloni njësinë e filtrit të heqjes së aromës në njësinë kryesore. ►Faqe 14

- Kur të fillojë operimi, nëse llamba e MODALITETIT vezullon, atëherë filtrin e heqjes së aromës nuk është fiksuar si duhet.
- Zbatoni rregullat vendore të ndarjes së mbeturinave kur hidhni qesen e filtrit dhe desikantin.

Operimi

Mos e fikni njësinë duke e hequr atë nga priza e energjisë. (Nga rrehja mund të shkaktohet zjarr ose goditje elektrike)




Përdorimi i operimit të pastrimit të ajrit (ndezja/fikja në ON/OFF e operimit)

Pastron ajrin në dhomë.

Shtypni .

- Ndizet llamba [blu] ON-OFF.
- Shtypni sërish për ta fikur në OFF.



Kujdes

- Mos e lëvizni njësinë ose ta fiksoni apo t'i hiqni pjesët nga njësia kur është në operim. Mund të shkaktohet këputje ose keqfunksionim.

Shënim

- Në kohën e blerjes, njësia është e vendosur në ventilatorin Turbo.
- Kur njësia hiqet nga priza ose FIKET, do të operojë me cilësimet e përdorura së fundmi herën tjetër që do të NDIZET.
- Cilësimet e operimit nuk mund të ndryshojnë për rreth 2 sekonda menjëherë pasi të futet spina e energjisë elektrike.

Ndryshimi i shkallës së qarkullimit të ajrit

Zgjidhni cilësimin e dëshiruar të VENTILATORIT.

 : I heshtur  : Standard  : Turbo

Simbolet ndryshojnë sipas cilësimit të VENTILATORIT.

Shtypni .

- Çdo shtypje kalon mes llambave [blu] të VENTILATORIT.



Rreth cilësimeve të VENTILATORIT

 **Quiet**

Del një fllad i butë.


Për të eliminuar shpejt aromat nga dhoma, rekomandohet që VENTILATORI të vihet në Standard ose më lart, përndryshe do të reduktohet kapaciteti i heqjes së aromës.

 **Turbo**

Ajri i ambientit pastrohet shpejt duke përdorur qarkullimin maksimal të tij.

Rekomandohet për përdorim kur pastroni dhomën.

Funksione të dobishme



Operimi i njësishë në një MODALITET

Zgjidhni MODALITETIN sipas sipas nevojave tuaja.

Shtypni .

- Çdo shtypje aktivizon dhe çaktivizon MODALITETIN E GJUMIT [blu].


 

MODALITETI	Përdorimi dhe funksioni
MODALITETI GJUME	Ofron një përvojë më të qetë dhe të rehatshme gjumi. ① Cilësimi VENTILATORI operon në ventilatorin e Heshtur për të ofruar një gjendje me më pak zhurmë. ② Llamba e VENTILATORIT dhe Streamer do të FIKEN. ③ Ky modalitet operon për 8 orë. ④ Pas 8 orëve, do të përfundojë automatikisht dhe do të aktivizojë sërish cilësimet e mëparshme.

Shënim

- Shtypja e  do të përfundojë MODALITETIN E GJUMIT.
- Kur të përfundojë MODALITETI I GJUMIT, do të ndezë sërish shpejtësinë e mëparshme të ventilatorit.

Funksione të dobishme



Përdorimi i bllokimit me kyç për fëmijë

Operimi i butonit është i kufizuar, duke parandaluar funksionimin e gabuar nga fëmijët e vegjël.

Mbani shtypur  **për rreth 3 sekonda.**

- Mbani shtypur  sërisht për rreth 3 sekonda për të fikur Kyçin e Bllokimit për Fëmijë.
- Kur bllokimi me kyç për fëmijë është aktiv, operimet do të kufizohen. Kur shtypet çfarëdo butoni, do të bjerë vetëm një tingull (3 bipe të shkurtra), duke e parandaluar operimin e gabuar nga fëmijët e vegjël.

Shënim

- Nëse njësia është e shkëputur nga kyçi për fëmijë është aktiv, atëherë ky kyç do të fiket.
- Llamba [blu] e bllokimit me kyç për fëmijë ndriçon kur funksioni është aktiv.

Përshtatja e ndriçimit të llambës së treguesit

Ndriçimi i llambës së treguesit përshtatet.

Mbani shtypur  **për rreth 3 sekonda.**


- Mbani shtypur  për rreth 3 sekonda për të kaluar nga një cilësim në tjetrin.



Shënim

- Ky funksion është i dobishëm nëse llambat ju shqetësojnë gjatë orarit të gjumit etj.
- Llamba ON-OFF nuk fiket edhe nëse ndriçimi është caktuar në OFF.
Llamba do të vendoset në I ZBEHTË.
- Nëse  ose shtypet  kur ndriçimi është i caktuar në OFF, ndriçimi do të ndryshojë në DIM dhe do të kthehet në OFF pas rreth 10 sekondave.

Cilësimet e përparuara



Nëse ju shqetëson zhurma e fërshëllimës e krijuar nga shkarkimi i Streamer ose aroma e ozonit

*Cilësimi në kohën e blerjes

Cilësimet e daljes të Streamer

I rregullt*

I ulët

Mbani shtypur dhe për rreth 3 sekonda me spinën e energjisë elektrike të futur në prizë dhe njësinë e fikur.

- Çdo herë që dhe mbahen shtypur për rreth 3 sekonda, cilësimi kalon nga "I rregullt" në "I ulët".

[Kur cilësimi ndryshon në "I ulët"]

Bie një bip i shkurtër dhe llamba e Streamer vezullon për rreth 5 sekonda.



[Kur cilësimi ndryshon në "I rregullt"]

Bie një bip i shkurtër dhe llamba e Streamer ndizet për rreth 5 sekonda.



■ Statusi i operimit të Streamer

Cilësimi i daljes të Streamer		I rregullt	I ulët
Cilësimi FAN			
VENTILATORI	I heshtur	NDEZUR- FIKUR**	FIKUR
	Standard		NDEZUR- FIKUR**
	Turbo	NDEZUR	NDEZUR

**Statusi ON-OFF i operimit të Streamer do të thotë se Streamer ndizet në ON dhe fiket në OFF në varësi të kontrollit të kohës.

Shënim

- Rekomandohet që Streamer të caktohet në "I rregullt", sepse kapaciteti i heqjes së aromës reduktohet kur është në "I ulët".
- Cilësimet ruhen në kujtesë edhe nëse njësia është e hequr nga priza.

Mirëmbajtja

Para punës së pastrimit dhe mirëmbajtjes, sigurohuni ta hiqni njësinë nga priza. (Mund të shkaktohet goditje elektrike ose lëndim)

Skara e rrjedhjes

■ Pastrimi i pjesës dalëse të ajrit (kur pluhuri bëhet problem)

Pastroni pjesën dalëse të ajrit me një furçë të butë.

- * Bëni kujdes që të mos bjerë pluhur brenda pastruesit të ajrit.
- * Nëse është e mbuluar me pluhur, fshini pluhurin me një leckë të butë të lagësht.
- Mos përdorni një furçë të fortë etj. (mund të shkaktohet këputje)



Njësia

Kur papastërtia bëhet problem **Fshini**


- Fshini papastërtinë me një leckë të butë të lagur.
- Kur grumbullimi i papastërtisë është i madh, lagni një leckë me detergjent neutral kuzhine dhe pastroni pluhurin.
- Mos përdorni furçë të fortë etj. (Mund të shkaktohet dëm)

Para-filtri (Para/Ana e majtë/Ana e djathtë)

Rreth çdo 2 javë

Pastroni me fshesë korrenti

Lani/Shpëlani



- Pas heqjes së çdo pluhuri duke përdorur një fshesë korrenti, hiqni dhe lani filtrin me ujë dhe pastaj lëroni të thahet në hije.
- Përdorni një furçë të butë kur pastroni hapësirat në rjetetë.

Kujdes

- Mos përdorni kruajtëse veshësh prej pambuku ose furçë të fortë etj. (Mund të shkaktohet këputje e pjesshme e filtrit)
- Mos ushtroni shumë forcë. (Mund të shkaktohet këputje e pjesshme/dëmtim i filtrit)
- Kur mbledhja e papastërtisë është serioze, lëroni pjesën të zhytet në ujë të vakët ose ujë në temperaturë ambienti të përzier me detergjent neutral kuzhine, hiqni plotësisht detergjentin me anë të shpëlarjes dhe lëroni pjesën të thahet në hije.

Heqja


Kapni pjesën e dhëmbëzuar të para-filtrit dhe tërhiqeni.

- ① Kapni pjesën qendrore të para-filtrit duke e shtyrë gishtin e madh në njësi.
- ② Tërhiqni drejt vetes.




Fiksimi

Vendosni grremçat (2 vende) në njësi dhe shtypni derisa të dëgjoni një "çëk".



Ana e kundërt


Vendosni grremçin (1 vend) në njësi. Shtyni të dy pjesët fundore derisa të fiksohen mirë.



Parë nga lart

Paralajmërim:

Për heqjen e para-filtrit (para), përdorni 3 gishta për ta tërhequr në drejtimin tuaj për të parandaluar dëmtimin e pashmangshëm të rretës së filtrit.



⚠ PARALAJMËRIM

- Mos përdorni gazolinë, benzinën, hollues, përbërës lëmimi, vajgur, alkool etj. (Mund të shkaktohet goditje elektrike, zjarr, ose plasaritje)
- Mos e lani kasën kryesore të njësisë me ujë. (Mund të shkaktohet goditje elektrike, zjarr, ose keqfunksionim/këputje)

Njësia e filtrit të heqjes së aromës

Kur ka shqetësime për aromë ose papastërtinë


Pastroni me fshesë korrenti

Mos përdorni ujë

- Hiqni nga njësia së bashku me skeletin dhe hiqni pluhurin duke përdorur një fshesë korrenti.
- Nëse aroma bëhet problem, lëreni pjesën diku në hije ku të fryjë pak filladi. (rreth 1 ditë)
- Mos e fërkoni sipërfaqen.
- Mos përdorni ujë kur pastroni. (Nëse përdoret ujë, pjesa do të humbë formën dhe do të dalë jashtë përdorimi.) ▶ [Faqe 17](#)




Mos e shkëputni filtrin e heqjes së aromës nga skeleti



Heqja

Mbani levën dhe dorezën e filtrit të heqjes së aromës dhe hiqeni.



Fiksimi

Vendosni plotësisht filtrin e heqjes së aromës.



- Nëse hiqet njësia e filtrit të heqjes së aromës ose vendoset gabim, do të vezullojë llamba e MODALITETIT.

Filtri i mbledhjes së pluhurit

Kur ka shqetësime për papastërtinë

Pastroni me fshesë korrenti

Mos përdorni ujë

- Hiqni pluhurin në filtri nga sipërfaqja pa etiketë duke përdorur një fshesë korrenti.
- (Bëni kujdes, sepse filtri dëmtohet lehtësisht.)
- Nëse filtri dëmtohet ose zmadohen porët, pluhuri do të kalojë përmes filtrit dhe kjo shkakton reduktimin e kapacitetit për mbledhjen e pluhurit.

Rreth çdo 10 vjet

Ndërroni


Rreth kohës së ndërrimit të pjesës

- Koha e ndërrimit varet nga modelet e përdorimit dhe vendndodhjes së njësisë.
- Nëse njësia përdoret çdo ditë në një shtëpi ku konsumohen 5 cigare në ditë, filtri duhet ndërruar rreth çdo 10 vjet. (Qarkullimi bazuar në metodën e testimit të standardit JEM1467 të Shoqatës Japoneze të Prodhuesve Elektrikë JEM1467.)
- Nëse përmbajtja e papastërtisë në ajrin e ambientit është e lartë, filtri do të ketë nevojë për ndërrime më të shpeshta.
- Nëse filtri nuk arrin përmbyshje detyrën, është koha ta ndërroni.

Rreth blerjes dhe hedhjes


- Referojuni "Pjesa e shitur veçmas". ▶ [Faqe 15](#)

Etiketa



Heqja


- ① Hiqni njësien e filtrit të heqjes së aromës.
- ② Tërhiqeni etiketën për lart.
- ③ Mbani pjesën e poshtme të filtrit të mbledhjes së pluhurit dhe ngriji për ta nxjerrë.



Fiksimi

- ① Instaloni filtrin e ri për mbledhjen e pluhurit, duke treguar kujdes me orientimin.

Ana me etiketë dhe shënime duhet të jetë me fytyrë nga jashtë dhe me shigjetën për lart



- ② Fiksni njësien e filtrit të heqjes së aromës.

Kujdes

- Sigurohuni që filtri i mbledhjes së pluhurit dhe njësia e filtrit të heqjes së aromës janë të fiksuar në njësien kryesore kur njësia është në operim. Nëse këto pjesë nuk fiksohen kur njësia është në operim, mund të shkaktohet këputje/keqfunksionim.
- Ndiqni këshillat më poshtë të parandaluar çngjyrosjen ose deformimin.
 - Nëse përdoret detergjent, sigurohuni ta pastroni plotësisht që të mos mbetet asgjë.
 - Nëse përdoret ujë i nxehtë, sigurohuni që të jetë 40°C ose më pak.
 - Mos i lini pjesët të thahen në diell.
 - Mos i thani pjesët duke përdorur tharës.
 - Mos përdorni zjarrin për pjesët.
- Nëse përdorni fshesë korrenti, sigurohuni të mos ushtroni forcë mbi pjesën ose ta përplasni atë. (Mund të shkaktohet dëmtim)


Pjesa e shitur veçmas

Kontaktoni me vendin e blerjes.

Pjesa e ndërrimit

Filtri i mbledhjes së pluhurit (1 copë)

Modeli: BAFP500A



- Ndërroni rreth çdo 10 vjet.

- Dështimi për të pastruar pjesët si duhet mund të çojë në:
 - Kapacitet të reduktuar për pastrimin e ajrit.
 - Kapacitet të reduktuar për heqjen e aromës.
 - Emetimin e aromave.

- Zbatoni rregullat vendore për ndarjen e mbeturinave kur hidhni filtrin e mbledhjes së pluhurit (prej poliestri dhe polipropileni).

■ Kërkesat për hedhjen



Produkti juaj dhe bateritë e furnizuara me kontrollorin shënohen me këtë simbol.

Ky simbol do të thotë se produktet elektrike dhe elektronike dhe bateritë nuk duhet të përzihen me mbeturinat e paklasifikuara shtëpiake.

Për bateritë, mund të shtypet një simbol kimik poshtë simbolit. Ky simbol kimik do të thotë se bateria mban një metal të rëndë mbi një koncentrim të caktuar. Simbolet e mundshme kimike janë:

■Pb: plumb (>0,004%)

■Hg: zhivë (>0,0005%)

Hedhja e këtij produkti duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin përkatës vendor dhe kombëtar.

Njësitë dhe bateritë për hedhje duhet të trajtohen në një vend të specializuar për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim.

Duke garantuar hedhje të saktë, do të ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin njerëzor.

Ju lutemi kontaktoni me instaluesin tuaj ose autoritetin vendor për më shumë informacion.

Kur nuk e përdorni njësinë për periudha të gjata

1. Hiqni spinën e energjisë elektrike.

2. Pastroni pjesët. ►Faqet 13, 14

- Në veçanti, elementet e pastruara me ujë duhet të jenë plotësisht të thata. (Nga lagështia e mbetur mund të shkaktohet myk)

3. Mbuloni pjesën e daljes së ajrit dhe vrimat e tjera me një qese plastike ose diçka të ngjashme për të penguar hyrjen e pluhurit dhe ruajeni njësinë në një vend të thatë në pozicion vertikal.



(Nga ruajtja e njësisë përmbys ose anash mund të shkaktohet keqfunksionim/këputje)

Rreth llambave të treguesit

Para punës së pastrimit dhe mirëmbajtjes, sigurohuni ta hiqni njësinë nga priza. (Mund të shkaktohet goditje elektrike ose lëndim)

Paneli i operimit/treguesit

Kontrolloni llambat e treguesit dhe përgjigjuni siç tregohet më poshtë.



Llamba e treguesit	Shkaku/Zgjidhja	
Vezullon llamba e MODALITETIT. ☀️ SLEEP 🌙	Kjo llambë vezullon nëse njësia e filtrit të heqjes së aromës është e shkëputur ose nuk është e lidhur si duhet. → Fiksoni si duhet njësia e filtrit të heqjes së aromës. ➡️ Faqe 14	
Vezullon llamba e Streamer. ☀️ ➡️	Ka ardhur koha për ndërrimin e njësisë Streamer. → Kontaktoni me vendin për ta blerë.	
Vezullon llamba e NDEZJES- FIKJES (ON-OFF). ☀️ ⏻	Një përbërës elektrik është me defekt. → Kontaktoni me vendin e blerjes.	
Të 3 llambat e VENTILATORIT po vezullojnë njëkohësisht. ☀️ ➡️ ☀️ 🌀 ☀️ 🌀	A janë lidhur para- filtrat dhe filtri i mbledhjes së pluhurit? Këto llamba mund të vezullojnë nëse njësia vihet në punë pa vendosur një pjesë	■ Nëse janë lidhur të gjitha pjesët Një përbërës elektrik është me defekt. → Kontaktoni me vendin e blerjes. ■ Nëse një ose shumë komponentë nuk janë lidhur Hiqni spinën e energjisë elektrike, fiksoni nga e para pjesët dhe pastaj ndizeni sërish njësinë.
	A ka mbledhje të pluhurit në para- filtrë?	■ Nëse nuk ka mbledhje të pluhurit Një përbërës elektrik është me defekt. → Kontaktoni me vendin e blerjes. ■ Nëse ka mbledhje të pluhurit Hiqni spinën e energjisë elektrike, pastroni para-filtrin dhe pastaj ndizeni sërish njësinë. ➡️ Faqe 13
	A është bllokuar pjesa dalëse e ajrit?	■ Nëse pjesa dalëse e ajrit nuk është e bllokuar Një përbërës elektrik është me defekt. → Kontaktoni me vendin e blerjes. ■ Nëse pjesa dalëse e ajrit është e bllokuar Hiqini çdo pengesë që bllokton pjesën dalëse të ajrit dhe pastaj ndizeni sërish njësinë.
	Këto llamba mund të vezullojnë nëse ka një rënie të papritur të voltazhit.	
	Nëse nuk ndodh asnjëra nga gjendjet e mësipërme, → Kontaktoni me vendin e blerjes. Rekomandohet heqja nga priza e njësisë derisa të mbërrijë agjenti i shërbimit.	


Pyetje e Shpeshta

Kontrolloni informacionin e mëposhtëm para se të kontaktoni.

Pyetje: A mund të pastrohet filtri i mbledhjes së pluhurit?

Përgjigje: Nëse mbledhja e papastërtisë është serioze, pastroni me fshesë korrenti ose ndërrojeni.

Mos tentoni ta pastroni me ujë, sepse mund të shkaktojë performancë të reduktuar të filtrit për mbledhjen e pluhurit. ►Faqe 14



Pyetje: Filtri i mbledhjes së pluhurit nxihet lehtësisht...

Përgjigje: Nxirja nuk ndikon në performancën e mbledhjes së pluhurit. Megjithatë, mund të ndërrohet nëse është problem.

Pyetje: A mund të pastrohet me ujë filtri i heqjes së aromës? Apo duhet ndërruar?


Përgjigje: Nuk mund të pastrohet me ujë.

(Nëse përdoret ujë, pjesa do të humbë formën dhe do të dalë jashtë përdorimi.)

Nëse e keni larë pa dashje me ujë, këshillohuni me pikën e blerjes.

Hiqni njësinë e filtrit të heqjes së aromës nga kasa kryesore dhe pastroni pluhurin me fshesë korrenti. Ndërrimi i filtrit nuk është i nevojshëm.

Nëse aroma bëhet problem, lëreni pjesën diku në hije ku të fryjë pak filladi. (rreth 1 ditë) ►Faqe 14



Zgjidhja e problemeve

■ Para se të bëni kërkesë për të dhëna ose riparim, kontrolloni si vijon.

Nëse problemi vazhdon, kontaktoni me pikën e blerjes.

■ Në rast keqfunksionimi gjatë operimit

Nëse llambat e treguesit ndriçojnë jo normalisht, ose dalin jashtë përdorimi, për shkak të një vetëtime etj., hiqni spinën e energjisë elektrike, prisni të paktën 5 sekonda pastaj rivendosni spinën dhe ndizeni sërish njësinë.



Nuk është problem

Ky rast nuk është problem.



Kontrolloni

Ju lutemi kontrolloni sërish para se të kërkon riparime.

■ Njësia nuk reagon

Fenomeni	Kontrolloni pikat
Asnjë reagim edhe nëse shtypet 	☒ • Për të mbrojtur sistemin, njësia mund të ndalojë së operuari pas një luhatjeve të papritura të mëdha të voltazhit. Nëse në kohën e luhatjes së voltazhit operohet, operimi do të vazhdojë automatikisht sapo voltazhi t'i kthehet normalitetit. Mbrojtja e gamës së voltazhit: 198V-264V

■ Mund të dëgjoen zhurma

Fenomeni	Kontrolloni pikat
Gjatë operimit të Lagështimit dëgjoen fërshëllimë	☒ Ndërsa Streamer po operon, njësia Streamer do të lëshojë një fërshëllimë kur kryhet shkarkimi i Streamer. Në varësi të përdorimit, volumi i zhurmës mund të bjerë ose të ndryshojë në një kërcëllimë, gumëzhitje ose përprijeje. Megjithatë, kjo është normale. Nëse zhurmat janë problem, provoni ta zhvendosni njësinë në një vend tjetër. ►Faqe 12
Gjatë operimit dëgjoen fishkëllimë dhe fërgëllimë	☐ • A ka mbledhje të pluhurit në para-filtër? → Pastroni këtë pjesë. ►Faqe 13 • A është bllokuar filtri i mbledhjes së pluhurit? → Në varësi të kushteve të përdorimit, filtri i mbledhjes së pluhurit mund të bllokohet, duke shkurtuar kështu jetëgjatësinë e servisit. ►Faqe 7 Ndërroni filtrin e mbledhjes së pluhurit. ►Faqe 14
Zhurma e operimit është e lartë	☐ • A është i lidhur si duhet filtri i mbledhjes së pluhurit? → Nëse nuk është fiksuar si duhet, zhurmat e operimit mund të shtohen. ►Faqe 14

■ Llambat e treguesit

Fenomeni	Kontrolloni pikat
Llambat e treguesit nuk ndriçojnë Llambat e treguesit fiken rreth 10 sekonda pas ndezjes së njësisë	☐ • A është caktuar ndriçimi i llambës së treguesit në OFF (Fikur)? → Nëse ndriçimi i llambës së treguesit është caktuar në OFF, të gjitha llambat përveç llambës ON- OFF do të mbeten të fikura. → Nëse ndriçimi i llambës së treguesit është caktuar në FIKUR, pasi njësia është ndezur, ndriçimi i llambave të treguesit do të jetë në "I ZBEHTË" për rreth 10 sekonda dhe pastaj FIKEN. ►Faqe 11

Zgjidhja e problemeve

Fenomeni	Kontrolloni pikat
Po vezullojnë të gjitha llambat e VENTILATORIT bashkërisht.   	☐ • A janë lidhur para-filtrat dhe filtri i mbledhjes së pluhurit? Këto llamba mund të vezullojnë nëse njësia vihet në punë pa vendosur një pjesë. [Nëse një ose shumë pjesë nuk janë fiksuar] → Hiqni spinën e energjisë elektrike, fiksoni nga e para pjesët dhe pastaj ndizeni sërish njësinë. [Nëse janë lidhur të gjitha pjesët] Një përbërës elektrik është me defekt. → Kontaktoni me vendin e blerjes. • A ka mbledhje të pluhurit në para-filtrat? [Nëse ka mbledhje të pluhurit] ► Faqe 13 → Hiqni spinën e energjisë elektrike, pastroni para-filtrin dhe pastaj ndizeni sërish njësinë. [Nëse nuk ka mbledhje të pluhurit] Një përbërës elektrik është me defekt. → Kontaktoni me vendin e blerjes. • A është bllokuar pjesa dalëse e ajrit? [Nëse pjesa dalëse e ajrit është e bllokuar] → Hiqini çdo pengesë që bllokoi pjesën dalëse të ajrit dhe pastaj ndizeni sërish njësinë. [Nëse pjesa dalëse e ajrit nuk është e bllokuar] Një përbërës elektrik është me defekt. → Kontaktoni me vendin e blerjes.
	☒ Llambat mund të vezullojnë nëse ka një luhatje të papritur të voltazhit. Llambat do t'i kthehen gjendjes së tyre të mëparshme sapo voltazhi t'i kthehet normalitetit. Mbrojtja e gamës së voltazhit: 198V – 264V.
	☒ • Nëse nuk ndodh asnjëra nga gjendjet e mësipërme, → Kontaktoni me vendin e blerjes. Rekomandohet heqja nga priza e njësisë derisa të mbërrijë agjenti i shërbimit.
Ndonjëherë llamba e Streamer nuk ndriçon	☒ • Streamer mund të ndalojë operimin në varësi të kontrollit të kohës. Llamba e Streamer fike kur Streamer ndalon së operuari.
Llamba e Streamer vezullon	☐ • Rekomandohet që Streamer të ndërrohet. → Kontaktoni me vendin e blerjes.
Llamba e MODALITETIT vezullon	☐ • A është fiksuar njësia e filtrit të heqjes së aromës? → Fiksoni njësinë e filtrit të heqjes së aromës. ► Faqe 14

■ Funkcioni për pastrimin e ajrit

Fenomeni	Kontrolloni pikat
Kapaciteti për pastrimin e ajrit është reduktuar	? • A është e pozicionuar njësia në një vend ku qarkullimi i ajrit nuk mund të arrijë ose është e rrethuar nga pengesa? → Zgjidhni një pozicion pa pengesa dhe nga ku qarkullimi i ajrit mund të arrijë të gjitha sipërfaqet e dhomës. • A janë bërë pis para-filtrat ose filtri i mbledhjes së pluhurit? → Pastroni këto pjesë. ► Faqet 13, 14
Pjesa dalëse e ajrit lëshon aromë	? • A është bërë pis filtri i heqjes së aromës? → Pastroni këto pjesë. ► Faqe 14 • Në disa raste pjesa dalëse e ajrit mund të lëshojë një aromë të lehtë teksa gjenerohen sasi gjurmësh të ozonit. Megjithatë, sasia është e papërfillshme dhe jo e dëmshme për shëndetin tuaj. • A është dhoma e mbushur me aroma për shkak të gatimit apo për shkak se disa njerëz pinë bashkë duhan etj.? → Aroma do të zbehet gradualisht, ndërsa njësia është në punë. • A keni lëvizur njësinë nga një dhomë tjetër? → Njësia mund të lëshojë aromën e dhomës ku është përdorur më parë. Lëreni njësinë të punojë edhe pak më gjatë. • A ka ndonjë gjë në dhomë që lëshon vazhdimisht aromë? (Bojë, mobilie të reja, letër muri, spërkatës, artikuj kozmetikë, lëndë kimike) → Meqenëse aroma që lëshohet vazhdimisht nuk mund të eliminohet plotësisht, duhet të ajrosni dhomën njëkohësisht ose ta vini për pak njësinë në punë në një dhomë të ajrosur mirë.
Nuk lëshon ajër	? • A është bllokuar pjesa dalëse ose hyrëse e ajrit? Nëse nuk janë bllokuar, atëherë motori i ventilatorit është me defekt. → Kontaktoni me vendin e blerjes.

■ Tjetër

Fenomeni	Kontrolloni pikat
Ventilatori ndalon në mes të operimit të njësise	? • A janë fiksuar para-filtrat dhe filtri i mbledhjes së pluhurit para se njësia të vihet në punë? Ventilatori është i konfiguruar të ndalojë për të mbrojtur përbërësit elektrikë nëse një pjesë nuk fiksohet si duhet. → Nëse një pjesë nuk fiksohet, hiqni njësinë nga priza dhe fiksoni të gjitha pjesët para se ta ndizni sërish njësinë.
Zhurma e shkarkimit të Streamer nuk mund të dëgjohet më	✓ • Operimi i Streamer varet nga kontrolli i kohës. ► Faqe 12
Në ekranin e televizorit ka pamje të dyfishta	? • A janë televizori ose radioja të pozicionuar 2 m larg njësise apo afër njësise është vendosur një antenë e brendshme? • A është vendosur afër njësise kordoni i energjisë elektrike ose kabloja e antenës së televizorit apo radioja? → Mbajeni njësinë sa më larg televizorit, radios ose antenës.
Vetëm futja e spinës së energjisë elektrike shkakton nisjen e operimit	? • A e keni shkëputur spinën e energjisë elektrike gjatë një avarie ose kur ka ndodhur një luhajtje e papritur e voltazhit, për ta zhvendosur njësinë ose shkëputur spinën e energjisë gjatë operimit të fundit? → Funkcioni i rinisjes automatike rifillon automatikisht operimin.

Specifikimet

Emri i modelit	MC30YVM		
Furnizimi me energji	1F, 220-240/220-230V, 50/60 Hz		
Modaliteti i operimit	Pastrimi i ajrit		
	Turbo	Standard	I heshtur
Konsumi i energjisë (W)	25	15	8
Zhurma e operimit (dB)	37	27	19
Shkalla e qarkullimit të ajrit (m³/orë)	180	120	60
Zona e mbulimit (m²)	23		*1
	46		*2
CADR (m³/orë)	180		*3
Përmasat e njësisë (mm)	450(Lartësi) x 270(Gjerësi) x 270(Thellësi)		
Pesha (kg)	5,8		
Gjatësia e kordonit të energjisë elektrike (m)	1,8		

Prodhuar në Malajzi

- **Këto vlera specifiki zbatohen për 50Hz 220–240V dhe 60Hz 220–230V.**
- **Kjo pajisje është synuar të përdoret në zona rezidenciale ose tregtare.**
- **Niveli i presionit të zërit nga emetimi i koeficientit A është nën 70 dB(A).**

*1. Zona e mbulimit u llogarit në përputhje me JEM1467. (kur cilësimi FAN është "Turbo")

*2. Sipërfaqja e mbulimit u llogarit në përputhje me standardin NRCC-54013 duke përdorur CADR për pirjen e cigares që u testua sipas JEM1467. (kur cilësimi FAN është "Turbo")

*3. Vlera CADR u testua sipas JEM 1467 Shtojca C.

- Në rast se ka konflikt në interpretimin e këtij manuali dhe përkthimet e të njëjtit në gjuhë të ndryshme, versioni anglisht i manualit do të mbizotërojë.
- Prodhuesi ruan të drejtën për të rishikuar specifikimin dhe dizajnin që gjendet këtu në çdo kohë pa njoftim paraprak.
- Të gjitha imazhet janë vetëm për qëllime ilustruese.

DAIKIN MALAYSIA SDN. BHD.

Loti 60334, Persiaran Bukit Rahman Putra 3,
Taman Perindustrian Bukit Rahman Putra,
47000 Sungai Buloh, Selangor Darul Ehsan,
Malajzi.

DAIKIN EUROPE N.V.

Zandvoordestraat 300, B-8400 Oostende,
Belgjikë

DAIKIN ISITMA VE SOĞUTMA SİSTEMLERİ SAN. TİC. A.Ş.

Gülsuyu Mahallesi, Fevzi Çakmak Caddesi, Burçak Sokak Nr:20
34848 Maltepe / STAMBOLL / TURQI
Tel: 0216 453 27 00
Faks: 0216 671 06 00
Çağrı Merkezi: 444 999 0
Ueb: www.daikin.com.tr

3P664947-9 D
